

MEKANIZMI KOORDINUES PER VENDIN

RINOVIMI I ANETARESISE MKV & MANUALI POLITIKAVE TE QEVERISJES

Fondi Global për AIDS-in, Tuberkulozin dhe Malarien (FGATM) duke qenë një mekanizëm financimi, ndjek parimin thelbësor të promovimit të rolit të vendit, i cili konsiderohet kritik për një përgjigje të qëndrueshme kombëtare.

Programet kombëtare të FGATM financohen përmes një procesi pjesëmarrjeje dhe zhvillimit të Concept Note me përfshirjen e aktorëve të shumtë. Proceset që ajo promovon janë të destinuara për të plotësuar programet kombëtare ekzistuese dhe politikat kombëtare. Prandaj, kërkon ndërtimin dhe lidhjen e programeve të saj me mekanizmat ekzistues në përputhje me Planet Strategjike Kombëtare si edhe me strategjitë për uljen e varfërisë dhe qasjeve të gjera sektoriale.

Rrjedhimisht, Mekanizmat e Koordinimit të Vendit (MKV) janë kryesor për angazhim e Fondit Global ndaj pronësisë lokale dhe pjesëmarrjes në vendim-marrje. Këto partneritete me aktorë të shumtë zhvillojnë dhe paraqesin propozimet për grante për Fondin Global në bazë të nevojave prioritare në nivel kombëtar. Pas miratimit të grantit, ato mbikëqyrin progresin gjatë implementimit.

Anëtarësimi i MKV duhet të jetë gjerësisht përfaqësues i palëve të ndryshme të interesuara, secili përfaqësues i një grupimi aktiv me interes në luftimin e një ose më shumë prej tre sëmundjeve të përmendura. Çdo përfaqësim sjell një perspektivë unike dhe të rëndësishme duke rritur kështu shanse të matshme të qasjes së ndikimit. Në këtë përfaqësim, përfaqësimi perspektiv gjinor është gjithashtu i rëndësishëm.

1. Rolet dhe Përgjegjësitë e MKV së Shqipërisë:

Qëllimi i MKV së Shqipërisë është të sigurojë që burimet e Fondit Global të përdoren për të mbështetur një qasje që është nxitëse për vendin, e koordinuar dhe multi-sektoriale, duke përfshirë të gjithë partnerët përkatës. Funkcionet kryesore të MKV Shqipëri, të udhëhequr tërësisht nga Plani Strategjik Kombëtar janë:

1.1 Të koordinojë zhvillimin dhe paraqitjen e propozimeve kombëtare për Fondin Global.

1.2 Të zhvillojë dhe zbatojë kriteret për emërimin e Përfituesi/ve Kryesorë (PR) dhe Nën-përfituesve (SR) për çdo propozim, i cili do të jetë i përfshirë në zbatimin e projektit, pasi propozimi të jetë miratuar.

1.3 Të mbikëqyrë granteve e Fondit Global në Shqipëri. Të mbikëqyrë zbatimin e aktiviteteve të financuara nga grantet e Fondit Global, duke siguruar që performanca e

Përfituesi/ve Kryesorë dhe Nën-përfituesve është monitoruar dhe vlerësuar. Të rishikojë raportet e progresit që përgatiten dhe dorëzohen pranë Fondit Global nga Nën-Përfituesit.

1.4 Të lehtësojë punën e Përfituesit/ve Kryesorë në riprogramimin e granteve. Të marr në konsideratë kur është e përshtatshme, miratimin e ndryshimeve në planet e zbatimit të granteve që janë propozuar nga Përfituesi/ve Kryesorë. Kur është e nevojshme, dorëzon kërkesa për Fondin Global për riprogramimin e granteve të miratuara.

1.5 Të kërkoj financim të vazhdueshëm nga Fondi Global. Paraqitja e kërkesave ndaj Fondit Global për financimin e vazhdueshëm për secilin grant të miratuar sipas kërkesave.

2. Rolet shtesë të MKV së Shqipërisë:

2.1 Të diskutojë politikat e Qeverisë, si edhe procedurat e tjera të lidhura me to, zbatimin e tyre dhe modifikimin e tyre kur është e nevojshme.

2.2 Të sigurojë transparencë në të gjithë procesin e shkëmbimit të informacionit dhe ta bëjë këtë informacion të aksesueshëm për publikun e gjerë.

3. Parimet Themelore të MKV

3.1 Në ndjekjen e mandatit të tij, MKV i përmbahet parimeve të pjesëmarrjes efektive, të gjerë dhe gjithëpërfshirëse, vendimmarrjes demokratike, respektit, sinqeritetit dhe transparencës, si edhe funksionimin efikas si më poshtë:

3.1.1 MKV do të veprojë si një grup kombëtar konsensual dhe do të promovojë partneritetin kombëtar në zhvillimin dhe zbatimin e granteve të mbështetura nga Fondi Global.

3.1.2 Përfaqësimi do të sigurohet nga të gjithë sektorët respektivë, siç përcaktohet në seksionin e mëposhtëm nën titullin "Anëtarësimi i MKV-së".

3.1.3 Përfaqësimi i sektorit jo-qeveritar do të përzgjidhet prej tyre, përmes një procesi transparent dhe të dokumentuar.

3.1.4 Të sigurohet transparencë e plotë në vendim-marrje.

3.1.5 Të gjithë anëtarët e MKV janë partnerë të barabartë, me të drejta të plota për pjesëmarrje, të drejtën e shprehjes dhe përfshirjes në vendimmarrje.

4. Si pjesë integrale e promovimit të transparencës, përgjegjësisë, gjithë përfshirjes dhe besimit të publikut në të gjitha aktivitetet e saj, MKV do të miratojë dhe do ti përmbahet Politikave të Konfliktit të Interesit. Politika e Konfliktit të Interesit është përfshirë në aneksin 5.

6. Përfituesi/it Kryesorë, Nën-përfituesit dhe Nën-nën-përfituesit pritet që t'i përmbahen kësaj Politike dhe të bëjnë të gjitha përpjekjet e mundshme për të shmangur konfliktet e interesit dhe pasi lindin, ti adresojnë ato në mënyrë efektive.

7. MKV duhet të promovojë lidhjet dhe qëndrueshmërinë ndërmjet aktiviteteve të Fondit Global në Shqipëri dhe Strategjisë Kombëtare të zhvillimit të vendit; strategjisë kombëtare të sëmundjeve, sistemit kombëtar të monitorimit, menaxhimit financiar dhe prokurimit, si edhe përpjekjet kombëtare për të rritur harmonizimin, koordinimin dhe efektivitetin e asistencës së huaj.

Struktura e MKV

8. Anëtarët e MKV përfaqësojnë interesat e palëve të interesuara në nivel kombëtar në luftën kundër HIV-it dhe Tuberkulozit. MKV ka në përbërjen e saj përfaqësues të palëve të interesuara të zgjedhur në nivel kombëtar për të zhvilluar plane në nivel vendi për marrjen e burimeve shtesë nga Fondi Global me qëllim përmirësimin e përgjigjes ndaj AIDS-it dhe Tuberkulozit në Shqipëri.

9. Konstitucionaliteti I politikë-bërësve në nivel kombëtar përfaqësuar nga anëtarësia e MKV do të përfshijë: sektorin qeveritar; sektorin akademik; Organizatat jo-qeveritare (OJQ); organizatat me bazë komunitare, personat që jetojnë me HIV dhe Tuberkuloz; popullatat kryesore të prekura: sektori privat përmes shoqatës së profesionistëve dhe partnerëve multi/ bilateralë në vend.

10. Madhësia e MKV nuk duhet të kalojë 17 anëtarë, në mënyrë që të sigurohet që MKV-ja mund të kryejë funksionet e veta në mënyrë efektive dhe efikase. Përbërja e anëtarësimit është specifikuar në seksionin e mëposhtëm nën titullin "Anëtarësim i MKV- Përbërja".

11. Çdo anëtar i MKV do të ketë një anëtar alternativë të caktuar që mund ta përfaqësojë gjatë mungesës së tij. Anëtari i emëruar duhet ti komunikojë në mënyrë të shkruar, të paktën 2 ditë para, Sekretariatit për mungesën e tij /saj.

12. Në mënyrë që të mundësohet funksionimi efektiv i MKV-s, mund të caktohen komisione ose grupe pune të përkohshme ose të vazhdueshme nga ana e MKV-s. Termat e Referencës për komisione të tilla ose grupe pune do të përcaktohen nga MKV-ja.

13. Komitetet e përhershme të MKV do të përbëhen si më poshtë:

13.1 Komiteti (Byroja) Ekzekutiv;

13.2 Komiteti Mbikëqyrës;

13.3 Komiteti i Zhvillimit të Propozimeve (kur dhe si kërkohet)/ Anëtarësia e MKV-s së Shqipërisë:

14. Anëtarësia e MKV do të jetë përfaqësuese e një shumëllojshmërie palësh të interesuara, secila me një konstituencë aktive në fjalë për të luftuar kundër HIV/AIDS-it dhe Tuberkulozin. Çdo konstituencë sjell një perspektivë unike dhe të rëndësishme për punën e MKV-s, duke rritur shanset e arritjes së ndikimit të matshëm kundër këtyre sëmundjeve. MKV do të sigurojë barazi gjinore dhe perspektivë në anëtarësimet e saj.

15. Si individë, anëtarët e MKV janë përgjegjës për sektorët që ata përfaqësojnë dhe si grupim i MKV-s përgjegjës para vendit.

16. MKV do të përbëhet nga 17 anëtarë të ndarë në bazë kushtetushmërie dhe nën-kushtetushmërie siç tregohet në tabelën më poshtë:

KUSHTTETUSHMËRIA	NR.	NËN- KUSHTTETUSHMËRIA
Sektori qeveritar	7	Ministria e Shëndetësisë: 1 Zyra Kundër Diskriminimit: 1 Ministria e Arsimit dhe Sporteve: 1 Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë: 1 Ministria e Financave: 1 Ministria e Brendshme: 1 Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve: 1
Partnerët Multilateralë / Bilateralë të Zhvillimit në vend	2	OKB: 1 Partnerët Bilateralë: 1
Njerëzit që jetojnë me këtë sëmundje	1	Rrjeti i personave që jetojnë me HIV/AIDS
Popullatat kryesore të prekura	4	Rrjeti i MSM-ve, PDI-ve dhe PKS: 2 Pacientë me TB / ish TB: 1 Organizatat e grave dhe të rinjve: 1

Sektori i Edukimit	1	Institucionet Publike Akademike: 1
Shoqatat e Profesionistëve	2	
Totali	17	

17. Anëtarët do të zgjidhen / emërohen për një mandat dy-vjeçar. Anëtarët mund të riemërohen për një mandat pasues me miratimin e konstituencës së tyre përkatëse siç është përcaktuar edhe në nenin e mëposhtëm "Procedurat e Zgjedhjeve / Emërimet e anëtarëve". Një anëtar do të shërbejë Jo më shumë se 4 vjet rrjesht. Anëtarët do të shërbejnë Jo më shumë se Dy mandate të njëpasnjëshme.

18. Të drejtat e anëtarëve të MKV-s:

Anëtarët e MKV kanë këto të drejta:

- Të gjithë anëtarët do të trajtohen si partnerë të plotë dhe të barabartë në MKV;
- Të drejta të plota shprehjeje dhe pjesëmarrjeje në procedura, takime dhe çdo veprimtari tjetër të përkthyer në gjuhën amtare.
- Të drejtën për të zgjedhur dhe për tu zgjedhur në postet e Kryetarit dhe Nënkyetarit;
- Të gjithë anëtarët kanë të drejtë për të votuar dhe çdo anëtar mund të kërkojë që të votohet për çështje të veçanta;
- Të gjithë anëtarët mund të shqyrtojnë propozimet e dorëzuara Fondit Global përpara çdo vendimi nga MKV-ja në lidhje me propozimet;
- Të gjithë anëtarët kanë të drejtë të nënshkruajnë, ose të refuzojnë për të nënshkruar, propozime të zhvilluara për dorëzim në Fondin Global;
- Të gjithë anëtarët do të kenë qasje në të gjitha informacionet, duke përfshirë raportet financiare dhe programatike, raportet e auditit si dhe planin e prokurimit.

Përgjegjësitë e Anëtarëve të MKV-s:

Pjesëmarrja: Të gjithë anëtarët e MKV-s pritet të marrin pjesë në mbledhjet e MKV dhe të kontribuojnë në mënyrë aktive në përputhje me rolet e tyre si anëtarë të MKV-s.

Përveç kësaj, anëtarët e MKV kanë përgjegjësitë e mëposhtme:

- T'u përmbahen dispozitave të këtij Udhëzuesi të Politikave dhe të gjitha manualeve të miratuara nga MKV-ja;
- T'u përmbahen Politikave të Konfliktit të Interesit të MKV-s në Shqipëri;
- T'u përmbahen udhëzimeve të Fondit Global lëshuar kohë pas kohe në lidhje me MKV-n dhe anëtarësinë e tij;
- Të ndajnë përvojat dhe informacionet në mbledhjet përkatëse të MKV-s;
- Të mbështesin dhe t'u përmbahen vendimeve të marra nga MKV-ja;
- Të raportojnë rregullisht mbi procedurat e MKV-s në lidhje me organizatat dhe individët nga sektorët e përfaqësuar nga anëtarët dhe kushtetushmërinë e tyre;
- Të marrin pjesë në shqyrtimin e performancës së granteve, përmes raportimeve për grantet, vizitave në terren ose rezultateve përmbledhëse.
- Këshillojnë MKV-n mbi çështjet dhe shqetësimet që dalin në kushtetushmërinë e tyre bazuar në ndërveprimin me konstituencat e tyre (Konstitucionalizmi Konsultues).

Anëtarët e MKV-s dhe zëvendësit/personat alteranivë:

Të gjithë anëtarët e MKV-s ose zëvendësit e tyre kanë detyrim të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e MKV-s. Në qoftë se të dy, si anëtari/ja ashtu edhe zëvendësi/ja e tyre marrin pjesë në një mbledhje MKV, vetëm anëtari ka të drejtën e votës. Në mungesë të anëtarit, zëvendësi ka të drejtë të votojë në emër të anëtarit, me lejen paraprake me shkrim të anëtarit, nëpërmjet komunikimit me Sekretariatit e MKV-s.

Përfaqësimi gjinor

MKV do të përpiqet të sigurojë dhe të inkurajojë që të paktën 30% e të gjithë anëtarëve të MKV-s të jenë femra.

Përfaqësimi gjeografik i anëtarëve

Do të bëhet çdo përpjekje për të siguruar që, rreth 10% e anëtarëve të MKV-s të jenë nga zonat rurale dhe nga zonat urbane përveç Tiranës.

Ekspertiza midis anëtarëve të MKV

MKV-ja duhet të sigurojë, sa më shumë të jetë e mundur, se do të ketë anëtarë në MKV me ekspertizë në fushat e mëposhtme: shëndet publik, kontabilitet dhe menaxhim financiar; menaxhim programesh; menaxhim të burimeve njerëzore; prokurimit, menaxhimit të furnizimeve dhe zhvillimit të propozimeve.

Procedurat për Zgjedhjet / Emërimet e anëtarëve

Në përputhje me parimet udhëheqëse të Fondit Global, MKV-ja ka miratuar udhëzimet e mëposhtme për zgjedhjen e përfaqësuesve konstitucionalë:

- Sektori Qeveritar: Për zgjedhjen e përfaqësuesve të Qeverisë, ftesa e MKV duhet tu drejtohet Drejtuesve të Ministrive përkatëse duke inkurajuar kështu pjesëmarrjen e zyrtarëve të lartë;
- OJQ-të / Organizatat me bazë komunitare, Personat që jetojnë me këto sëmundje, Popullatat kryesore të prekura, Sektori Privat, Sektori Akademik dhe Sektorin i Edukimit etj:

Anëtarët e MKV-s që përfaqësojnë sektorët jo-qeveritarë do të zgjidhen / emërohen nga grupimi i tyre në bazë të një procesi të dokumentuar, transparent, të zhvilluar në kuadër të çdo grupimi- duke përfshirë kërkesat e ligjshmërisë;

Partnerët Multilateral dhe bilateralë të zhvillimit në vend: të zgjedhur / të emëruar nga konstitucionaliteti i tyre.

- Çdo konstitucionalitet i përfaqësuar në MKV zgjedh / emëron numrin e anëtarëve siç parashikohet në seksionin "Anëtarësimet e MKV" më sipër duke dhënë një zëvendës për çdo anëtar. Anëtari dhe zëvendësi i tij / I saj do të vijin nga e njëjta organizatë e zgjedhur / e emëruar. Detajet e procesit të rinovimit të anëtarëve / organizatave të zgjedhura janë në pjesën "Protokolli i zgjedhjes së anëtarëve".

Anëtarët që përfaqësojnë një konstitucion jo-qeveritar të tilla si Organizatat vendore jo-qeveritare, Organizatat me bazë komunitare, Rrjetet e Organizatave të grave, Përfaqësuesit e personave që jetojnë me këto sëmundje, popullatat kryesore të prekura, sektori privat dhe institucionet akademike do të përbëjnë në paku 40% të anëtarësisë së MKV-së.

Anëtarët e MKV që përfaqësojnë një konstitucion jo-qeveritar do të zgjidhen / emërohen nga titullarët e tyre bazuar në kriteret e miratuara nga MKV-ja dhe përmes një procesi transparent, të dokumentuar, të zhvilluar nga çdo konstitucion. Konstitucionet gjithashtu do të zgjedhin/emërojnë zëvendësin që do të përfaqësojë anëtarin në mbledhjet e MKV në mungesë të anëtarit.

Protokolli i zgjedhjes së Anëtarësisë:

Procesi zgjedhor për secilën prej konstitucioneve jo-qeveritare duhet të përshkruhet në mënyrë të qartë në një dokument me qasje publike që tregon sesi janë zgjedhur/ emëruar individët anëtarë dhe zëvendësit e tyre, gjithashtu edhe mjetet me të cilat ata do të raportojnë dhe përfaqësojnë pikëpamjet e konstitucioneve të tyre përkatëse në mbledhjet e MKV-s. Dokumentimi i këtyre proceseve duhet të sigurohet nga MKV-ja, një kopje e së cilës

duhet ti dërgohet Fondit Global në Gjenevë dhe kopja tjetër të mbahet në Sekretariatit e MKV si rekord publik.

Dokumentat që mund të shërbejnë si dëshmi e mjaftueshme gjatë procesit zgjedhor / emërimit të anëtarëve nga konstitucionet jo-qeveritare përfshijnë:

- (i) Listat e anëtarëve nga organizata/t që marrin pjesë në zgjedhje / emërim;
- (ii) Letër nga organizatat që marrin pjesë në zgjedhjet / emërimet ku shpjegohen proceset dhe kriteret e emërimit në zgjedhjen e anëtarëve;
- (iii) Procesverbalet e mbledhjeve të zgjedhjeve / emërimeve konstitucionale.

MKV-ja duhet të shpalli publikisht datën e zgjedhjes së anëtarëve të rinj, si dhe informacionin përkatës në lidhje me procedurat sipas të cilave anëtarët e secilit konstitucion mund të marrin pjesë në procesin zgjedhor, dy muaj para skadimit të mandatit të anëtarëve.

Procesi zgjedhor duhet të ndjekë të gjitha procedurat e përcaktuara në këtë dokument.

Përfaqësuesit e zgjedhur / emëruar nga Qeveria ose zonat multi / bilaterale duhet të jenë zyrtarë të lartë, mundësisht të nivelit të kreut/ shefit të institucionit të konstitucionit përkatës. Agjencitë qeveritare dhe konstitucionet multi / bilaterale gjithashtu duhet të emërojnë zëvendësit e anëtarëve të përfaqësuar në mbledhjet e MKV, në rastin e mungesës së anëtarit.

Në rast të një mosmarrëveshjeje të rëndësishme brenda një konstitucioni gjatë procesit të zgjedhjes / emërimit që nuk mund të zgjidhet nga vetë konstitucioni, Komiteti Ekzekutiv i MKV-s duhet të hetojë rastin dhe të bëjë një rekomandim për MKV-n për mënyrën sesi mosmarrëveshja duhet të zgjidhet.

Publikimi / Komunikimi i listës së Anëtarësimit

Gjatë tremujorit të parë të çdo viti, MKV duhet t'i paraqesë Sekretariatit të Fondit Global për botim në faqen e saj, listën e anëtarësimit të MKV-s me emrin e secilit anëtar, organizatës (nëse ka) dhe konstitucionalitetin përkatës. Gjithashtu, MKV-ja duhet ta bëjë këtë listë të ofrueshme për publikun e Shqipërisë, duke përdorur të gjitha mjetet e përshtatshme. Çdo ndryshim në anëtarësinë e MKV duhet ti komunikohet brenda dy javësh Sekretariatit të Fondit Global dhe duhet përditësuar në faqen zyrtare.

Largimi i anëtarëve nga MKV

Nëse ndonjë prej anëtarëve të MKV rezulton të ketë punuar kundër interesit të përgjithshëm të programit të Fondit Global në Shqipëri ose dështon në kryerjen e detyrave si anëtar i MKV-s, atij / asaj do ti dërgohet një njoftim për paralajmërim dhe çështja do të

shqyrtohet nga MKV-ja. Në rast të kundërt MKV-ja mund të votojë për largimin e anëtarit në mes të afatit të mandatit.

Largimi i tillë mund të iniciohet nga një mocion i ndërmarrë nga katër anëtarë të MKV-s dhe nga dy anëtarë të MKV-s për personat alternativë dhe do të votohet nga një shumicë prej dy të tretat e votave. Kjo shumicë prej dy të tretave do të thotë dy të tretat e anëtarëve të totalit të numrit të anëtarëve të MKV-s. Personat Zëvendësues të tyre nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në votim.

Përfundimi i anëtarësisë

Anëtarësimi mund të përfundojë me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në një mbledhje me kuorumin e nevojshëm, nëse një anëtar nuk merr pjesë më shumë se tri mbledhje të rregullta të njëpasnjëshme të MKV-s gjatë në një viti kalendarik.

Hapat e duhura megjithatë, do të ndërmerren sipas gjykimit dhe konsideratave të MKV-s përpara ndërprerjes së anëtarësimin. Fillimisht, pas mungesë të parë do tu dërgohet një komunikim nga MKV-ja për të kërkuar informim për frekuentimin e ardhshëm. Kjo do të pasohet me komunikime të ngjashme pas çdo mungese të mëvonshme. Ky process do të kryhet nga Sekretariati i MKV-s nën drejtimin e Komitetit Ekzekutiv.

Kur anëtarësimi i një personi të MKV-s është ndërprerë, ose personi jep dorëheqjen nga anëtarësimi i tij/saj në MKV, konstituencia që ai përfaqëson mund të zgjedhin / përzgjedhin një person tjetër për të shërbyer për pjesën e mbetur të mandatit të anëtarësimin.

Një anëtar i larguar nga organizata e tij / saj e tanishme automatikisht humb antarësinë e tij / saj në MKV. Në një situatë të tillë, për rastin e anëtarit me përfaësim prej Qeverisë/multilateralë ose partnerët Bilateralë, personi alternativë i tij / saj i përcaktuar e zëvendëson në detyrë derisa anëtari I ri ti bashkohet MKV-s. Në rastin e OSHC-ve personi alternativë do të bëhet anëtarë me të drejta të plota për pjesën e mbetur të mandatit.